



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:092863

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05762973

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.364/22

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija në çështjen penale kundër të pandehurve B., L., dhe Q. M. për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së ndërsa për të pandehurin M. M. për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.636/22 të datës 10.05.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 28.05.2024 në prezencë të prokurores së shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, të pandehurit B., L., Q. M. dhe M. M., me dt.29.05.2024 shpalli ndërsa me datë 31.05.2024 përpiloi këtë

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

1.B. M.i lindur me datën në Pejë, nga i ati ... dhe e ëma ... e gjinisë, me vendbanim në fsh. Z., Komuna e Pejës, ka të kryer shkollën e fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i identifikuar në bazë të numrit personal, posedon nr. tel. 049/...-....

2.L. M.i lindur me datën në S./ Tirqino, nga i ati ... dhe e ëma e gjinisë, me vendbanim në rr. nr.16 Pejë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, beqar, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më profesion punëtorë, i identifikuar në bazë të numrit personal, posedon nr. tel. 049/...-....

3.Q. M. i lindur me datën në Pejë, nga i atidhe e ëma e gjinisë ..., me vendbanim në rr. nr.16 Pejë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, beqar, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më profesion punëtorë, i identifikuar në bazë të numrit personal, posedon nr. tel. 049/...-....

4.M. M. i lindur me datën në J., nga i ati dhe e ëma ..., e gjinisë, me vendbanim në Pejë, rr. “....” hyrja I-nr. I banesës 2, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba I katër fëmijëve, i nacionalitetit Shqiptar , shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i identifikuar në bazë të numrit personal, posedon nr. tel. 044/...-....

SHPALLËN FAJTOR

Për shkak se :

Të pandehurit B., L. dhe Q.M.

I. Me dt. 22.01.2022 rreth orës 20:20 në rr.” në Pejë me dashje dhe në bashkëkryerje i shkaktojnë lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit *M. M.*, në atë mënyrë që, përderisa i dëmtuari dhe i pandehuri B. M. ishte në lokalin ...duke biseduar në lidhje me një borxh, ky i fundit i fton djemtë e tij (dy të pandehurit e tjerë) dhe me të dalur në rrugën “....” afër marketit Luani-1 pas një mosmarrëveshje të momentit të pandehurit B., L.dhe Q. M.e sulmojnë të dëmtuarin *M.Maxhunin* duke e goditur me grushte dhe shqelma në pjesë të ndryshme të trupit dhe duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore-*plagë shqyese-ndrydhese të ideve të buta të rexhionit përreth syrit të djathtë dhe rexhionit të gjurit të këmbës së djathtë,*

-me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I Pandehuri Murat Magjuni

II. Me dt. 30.01.2022 rreth orës 21:58, seriozisht, me fjalë e kanos tjetrin se do t’i shkaktojë ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit dhe atë të dëmtuarin *B. M.* në atë mënyrë që, pas një mosmarrëveshje që kishin para rreth një jave si në dispozitivin I, i pandehuri e thërret në telefon

të dëmtuarit dhe e kanosë me fjalët “kur të shihemi ja ki me ma qi nënën ja kom me ta qi nënën”, me çka tek ky i fundit shkakton frikë dhe panik,

-me çka ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (O6/L-074):

GJYKON

I. Të pandehurve B., L., Q. M. secilit veç e veç u shqiptohet:

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të dënuarit nuk do të kryejnë vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) vitesh, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Te pandehurit M. M. i shqipton:

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III.Obligohen të dënuarit qe secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën nga 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën nga 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

IV. Të dëmtuarit udhëzohen që kërkesën pasurore juridike t’a realizojnë në kontest të rregullt juridiko-civil.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 10.05.2024 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.636/22 kundër të pandehurve B., L., Q. M. për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4

lidhur me nenin 31 të KPRK-së ndërsa për të pandehurin M. M. për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 28.05.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurorja e shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, të pandehurit B., L., Q. M. dhe M. M., në të cilën seancë të pandehurit secili veç e veç u deklaruan se e pranojnë fajësinë për veprat penale që u vihen në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe në kuptim të nenit 242 par.2, nënpar.2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe par.6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit, pasi që është e qartë se e kuptuan natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, prokuroja e shtetit deklaroi “ Pasi që të pandehurit e pranuan fajësinë e ky pranim fajësie gjen mbështetjen në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës, unë mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik dhe i propozoi gjykatës që të pandehurit ti shpalle fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimi i fajësisë të merret si rrethane lehtësuese”.

I pandehuri B. M. deklaroi “Nuk kam çka të deklaroj”.

I pandehuri L. M.deklaroi “Nuk kam çka të deklaroj”.

I pandehuri Q. M. deklaroi “Nuk kam çka të deklaroj”.

I pandehuri M. M. deklaroi “ Unë i kam thënë ashtu bashkimit në telefon se ky mi ka qu dy vetë të dera dhe më kanë thënë se ka thonë B.mos të nxo në Qendër Zejtare se kam me të vra, mbas kësaj telefonate jemi takuar por pa probleme tjera nuk kemi pasur, unë prej këtij rasti në Qendër Zejtare nuk kam shkua dhe jam detyrua me shkua në Prizren, mu më vjen keq që e kam sha së është baba i fëmijëve se përmes telefonit nuk shahet burri”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat

38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Përcaktimi i dënimit me burgim prej 1 (një) viti për të pandehurit B., L. dhe Q. M. dhe dënimit prej 90 (nëntëdhjetë) ditë për të pandehurit M. M. u bë dukë e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, që sipas praktikës gjyqësore dhe udhëzuesit të Gjykatës Supreme, pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale të kryer nga të pandehurit B., L. dhe Q. M. është dënimi me burgim prej një vit e gjashtë muaj, ndërsa për veprën penale të kryer nga i pandehuri M. M. është dënimi me burgim prej shtatë muaj¹.

Pastaj, duke vlerësuar rrethanat renduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurit nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurve do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurve, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurve se nëse në periudhën verifikuese prej dy përkatësisht katër vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tyre do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

¹ Udhëzues për Politiken Ndëshkimore i Gjykatës Supreme të Kosovës, fq 201.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e ne këtë rast siç u përshkrua me lartë për veprën penale që janë shpallur fajtor i pandehuri B., L. dhe Q.M. është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet ndërsa për te pandehurin M. M. është parapare mundësia e shqiptimit te dënimit me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurve është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata vendosi që të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohet në kontest të rregullt civil, e kjo duke u bazuar në nenin 462 par.2 të KPPRK-së.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.364/22, me datë 31.05.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.